



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 20.11.2018

Dokument parlamentar

**RAPORT
PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.102/2015, “PËR SEKTORIN E
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR”**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 20 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhje ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësues të KESH sha-së, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Ky projektligj vjen në kuadër të reformës së deregullimit, e cila ka si qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative. Ndryshimet që synon kjo reformë janë reduktimi i barrierave administrative, liberalizimi i tregut, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit.

Projektligji propozon shfuqizimin e licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B, duke bërë që ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale, lidhur me burimet hidrokarbure të jetë i lirë, por duke parashikuar që personat fizikë ose juridikë duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie të tyre, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe duhet të kenë të punësuar specialistë të pajisur me certifikatë profesionale e cila lëshohet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet bazuar në kriteret e vendosura nga Këshilli i Ministrave.

Kjo licencë është një nga licencat e parashikuara në vendimin nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar, i cili do të ndryshojë duke reflektuar edhe këtë ndryshim në ligjin nr 102/2015.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord me shumicë votash për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

Andrea MARTO

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar